

# REVISTA VJETORE

SINDIKATA E PUNONJËSVE POSTË-TELEKOM



SHKURT 2016



Rruga: "Myslym Shyrrri", Nr. 42, Tiranë, Albania.

[info@sindikata.net](mailto:info@sindikata.net)

[www.sindikata.net](http://www.sindikata.net)

FACEBOOK PAGE: Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT

<https://www.facebook.com/sindikatapostetelekom/>

## NE BRENDESI TE REVISTES

## KUSH JEMI?

SPPT është një organizatë sindikaliste e punonjësve të Albtelecom, Makhes dhe Postës Shqiptare, themeluar në Shkurt të vitit 1991. Që nga themelimi, ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia politike, etnia, raca, profesioni, gjinia apo bindja fetare.

Themelimi i Sindikatës së bashkuar të PTT në të gjithë Shqipërinë u vendos në Shkurt të Vitit 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky Kongres u zgjodhen edhe Drejtuesit e parë të SPPT-s, ku Kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, Zv/Kryetar. z. Shpëtim Vojka dhe Sekretar z. Aleksandër Miraj. Në vazhdim Sindikata është drejtuar nga të zgjedhurit e mëposhtëm sipas Kongreseve përkatëse që ka organizuar SPPT.

**Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka**

**Kongresi III 2001- z. Aleksander Miraj**

**Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojka**

**Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojka**

**Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj**

SPPT është një organizatë e ngritur mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin Kombëtar dhe Ndërkombëtar për punën dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPT rregullon marrëdhëniet mes punëdhënësit dhe punonjësve të punësuar në Albtelecom, Makhes dhe Postën Shqiptare.

SPPT është e organizuar në të gjithë Shqipërinë me disa qendra Rajonale. SPPT është një nga Sindikatat themeluese dhe anëtare e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Gjithashtu SPPT është anëtare në Federatën më të madhe Ndërkombëtare të Sindikatave, UNI GLOBAL, e cila përfaqëson 20 milion punonjës, me 900 Sindikata në 140 vende të ndryshme

# PËRSHENDETJA E KRYETARIT

## Të nderuar punonjës,

Në këtë përvjetor të 25-të kam kënaqësinë t'ju drejtohem të gjithëve ju përmes këtij botimi që vjen për herë të parë nga Sindikata e Punonjësve Postë-Telekom. Ky botim i cili është menduar të jetë një përmbledhje vjetore e të gjithë aktiviteteve tona, në numrin e parë të tij pasqyron një pjesë të veprimtarisë së saj fokusuar konkretisht në tre vitet e fundit.



Që nga themelimi në Shkurt të vitit 1991, kjo sindikatë ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë të gjithë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia etnike, raca, profesioni, gjinia apo bindja fetare. Prej 25 vjetësh misioni i kësaj sindikate ka qënë mbrojtja dhe promovimi i interesave të anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin përkatës për punën dhe të drejtat e njeriut.

Gjatë këtyre 25 viteve sfidat kanë qënë të vështira për drejtuesit e kësaj sindikate si në sektorin publik ashtu edhe pas privatizimit të Albtelecom. Ata janë përballur me sfida të ndryshme të cilat janë munduar t'i zgjidhin në favor të punonjësve, duke marrë përsiper përgjegjësitë që iu janë ngarkuar në vite. Zgjedhja e një femre si kryetare e parë e sindikatës, tregon vlerat e larta që kjo sindikatë ka percjellë që në fillimet e saj duke qënë një shembull i demokracisë së brendshme dhe respektimit të barazisë gjinore.

Me marrjen e detyrës si kryetar në Kongresin e VI të SPPT-së, mbajtur më 11 Prill 2014 kam nisur menjëherë punën për vitalizimin e strukturave dhe përshtatjen e tyre në funksion të të gjithë punonjësve. Organizimi i ri i sindikatës me nga dy përfaqësues përgjegjës në seksione riktheu në sindikatë një numër të konsiderueshëm anëtarësh. Kjo strukturë na dha mundësinë të informoheshim direkt për shqetësimet, sygjerimet apo pritshmëritë e punonjësve për sindikatën. Këshilli i ri kombëtar i dalë pas kongresit të VI-të në mbledhjet e tij periodike vendosi të ndërmarrë aktivitete të ndryshme për të sensibilizuar punonjësit për t'u anëtarësuar në sindikatë. Gjithashtu, këto aktivitete u përdorën edhe për të rigjallëruar anëtarësinë aktuale e cila nuk kishte informacionin e duhur mbi veprimtarinë e sindikatës. Informimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete ka rikthyer ndjeshëm besimin e tyre në sindikatë.

Një element tjetër të cilit i është kushtuar rëndësi ka qënë edhe rritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të sindikates. Në mjedisin e sotëm ne të cilin sindikata jonë operon është shumë e rëndësishme që në tavolinat e diskutimit përfaqësuesit tanë të jenë tepër të përgatitur për të negociuar lidhur me problematikat që mund të përballen. Edukimi i tyre me metoda perendimore nga partnerët e huaj si UNI Global Union dhe Solidarity Center (AFL-CIO – Sindikata Amerikane)

ka rritur ndjeshëm aftësitë e përfaqësuesve të seksioneve për t'u shërbyer më mirë nevojave të punonjësve. Përkushtimi i përfaqësuesve të Sindikatës gjatë këtyre Seminareve ka rritur në maksimum efikasitetin e lëvizjes së SPPT-së edhe me fushata konkrete sic ishte Fushata Fix-IT ku të gjithë punonjësit nën drejtimin e përfaqësuesve të Sindikatës arritën të përçonin mesazhin e tyre te drejtuesit e Kompanisë.

Pavarësisht rezultateve të arritura gjatë këtyre 25 viteve, sërish sindikata është në një luftë të vazhdueshme përballë sfidave me të cilat mund të ndeshet në të ardhmen. Patja e një plani strategjik të mirfilltë na ndihmon për të tejkaluar të gjitha këto sfida. Në hartimin e këtij plani strategjik kemi patur parasysh që të fokusohemi në:

- forcimin e sindikatës duke rritur numrin e anëtarëve
- në krijimin e një klime demokratike në organizatë
- në rritjen e transparencës mbi aktivitetin sindikal
- në rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të sindikatës
- në rritjen e informimit të anëtarëve mbi veprimtarinë.
- në zgjerimin e sindikatës në nivel sectorial.

Me anë të këtij plani strategjik synohet t'i jepet SPPT-së dhe anëtarëve të saj shanci që të jenë një shembull në lëvizjen sindikaliste në Shqipëri. Ne jemi të angazhuar që të plotësojmë çdo pikë të këtij plani për të shtyrë këtë lëvizje si brenda edhe jashtë kompanisë ku me qindra punonjës janë ende të paorganizuar dhe të pambrojtur ndaj punëdhënësit.

Të gjithë punonjësit duhet të kuptojnë se asnjëherë nuk do të na i japin të drejtat tona në rast se nuk luftojmë të gjithë bashkarisht për to. Cdo punëdhënës është i predispozuar mos të lëshojë nga pushteti i tij dhe ta përdori atë në maksimum për të shfrytëzuar punëmarrësin në çdo moment që i jepet mundësia. Prandaj të gjithë duhet ta kenë të qartë që në këtë përballje duhet të mbeshtetemi tek njëri-tjetri dhe i vetmi mjet për të arritur zgjidhjen e suksesshme të këtyre problemeve është sindikata.

Duke patur besimin se bashkarisht do të vazhdojmë të kontribuojmë në rritjen dhe forcimin e sindikatës, dua t'i uroj sindikatës sonë në këtë 25 vjetor edhe shumë vite të tjera të suksesshme në shërbim të punonjësve!



**VAZHDIM I  
POLITIKAVE PËR  
TË NDRYSHUAR  
OPINIONIN E  
PUNONJËSVE PËR  
SINDIKATEN**



**FOKUSIM  
TË RITJIA E  
KAPACITETEVE TË  
SINDIKATËS**



**BASHKËPUNIM ME  
PARTNER BRENDA  
& JASHTË VENDIT  
PËR LEVIZJEN  
TONË SINDIKALE.**



**ZHVILLIMI I  
FORMAVE TË REJA  
TË ORGANIZIMIT**



**APLIKIMI I  
TEKNIKAVE TË  
REJA PËR RITJEN  
E ANTARËSISË**

## KONGRESI I VI – 11 Prill 2014

Më 11 Prill 2014, SPPT mbajti në Tiranë Kongresin e saj të 6-të. Kongresi ishte një sukses për nga mënyra e të organizuar, ku nuk mungonin shumë delegacione të huaja por edhe personalitete të larta të vendit dhe perfaqësues të kompanisë. Kongresi u hap nga z. Shpetim Vojka i cili mbajti edhe raportin e analizes se aktivitetit te Sindikates per periudhën katër vjecare.



Gjatë punimeve Kongresin e përshëndetet shumë personalitete, duke filluar nga Këshilltari i Ministrit, zv/Drejtori i Përgjithshëm i Albtelecom z. Osman Dinler, Perfaqësuesi i UNI Global, z, Pav Aktar, zv/drejtorin e Pergjithshem i Postes Shqiptare, përfaqësuesi i BSPSH-së dhe duke vazhduar me Sindikaten e Turqise, Kosoves, Kroacise, Maqedonise dhe Greqise.



# KONGRESI I VI

Mbas pershendetjeve të rastit kongresi vazhdoi punimet me seancen e dytë për të zgjedhur organet e reja drejtuese të Sindikates. Z. Shpetim Vojka, kishte vendosur më përpara mos të kandidonte më për kryetar të Sindikatës por kishte propozuar ndryshimet në skemën e drejtimit të Sindikatës ku, ishte propozuar që roli i Kryetarit dhe Sekretarit të përgjithshëm të kishin përgjegjësi të përbashkëta në drejtimin e Sindikatës. Për të dy këto pozicione kandidonin në kongres z. Renato Mucaj dhe z. Kreshnik Mjaltaj. Sipas rezultatit të votimit i pari që mernte shumicën e votave do të shpallej edhe kryetari i ri i SPPT-së.



Përpara votimit të propozimeve statuoare, fjalën e mori z. Mucaj, i cili ju drejtua delegatëve me një fjalim ku ju sqaroi që një ndryshim i tillë mund të jetë i rrezikshëm dhe mund ta coj Sindikatën në një ngërc institucional. Prandaj z. Mucaj ju kërkoi të gjithë delegatëve mos ta votonin këtë pikë por ti bashkoheshin kërkesës së depozituar nga një grup delegatësh për të ndryshuar këtë propozim dhe për të lënë në fuqi pozicionin e Kryetarit si pozicion ekzekutiv dhe pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm si pozicion administrativë. Propozimi i z. Mucaj hapi diskutime në sallë ku mbas këtyre diskutimeve u hodh në votë ky propozim i cili u pranua nga shumica e delegatëve.



# - 11 Prill 2014




Kongresi më pas vazhdoi me votim të fshehtë për të zgjedhur Kryetarin e Sindikatës. Në përfundim të votimit dhe të numrimit të votave nga komisioni i votimit në prani të gjithë delegatëve rezultoj fitues z. Renato Mucaj. Kryetari i ri i Sindikatës bëri betimin përpara delegatëve dhe mbajti fjalën përshëndetëse për mbylljen me sukses të Kongresit. Me pas për të gjithë të ftuarit dhe delegatët u mbajt dreka e Kongresit.



# SKEMA ORGANIZATIVE E SINDIKATËS SË PUNONJËSVE POST-TELEKOM

Në Kongresin e VI, mbajtur në Tiranë, me 11 Prill 2014, SPPT zgjodhi Strukturat e reja dhe Kryetarin e Ri të saj, z. Renato Muçaj. Në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës edhe të drejtës që i jep Statuti i SPPT-së, Kryetari paraqiti në Mbledhjen e Parë të Këshillit Kombëtar Strukturën e re Organizative, si dhe propozimet për Anëtarët e Kryesisë, Forumit të Gruas dhe Forumit të Rinisë. Në përfundim të Mbledhjes së parë të Këshillit Kombëtar u aprovua në unanimitet nga anëtarët e Këshillit Kombëtar, Skema organizative dhe Strukturat e reja të SPPT-së;



# KRYESIA E SPPT-së



Renato Mucaj  
Kryetar



Zenel Muca  
zv. Kryetar



Elida Qepi  
zv. Kryetare



Kreshnik Mjaltaj  
zv. Kryetar



Mihal Hroni  
(anetar Kryesie)



Gentiana Mino  
(anetare kryesie)



Mihal Hroni  
(anetar Kryesie)



Rrezart Cela  
(anetar Kryesie)



Andiola Dhëmbi  
Sekretaria e përgjithshme



Myftar Rada  
(anetar Kryesie)

# ORGANIZIMI I SEKSIONEVE TË SINDIKATËS SË PUNONJËSVE POST-TELEKOM

Pas mbajtjes së Kongresit të VI, me zgjedhjen e Kryetarit të ri z. Renato Muçaj, filloi edhe puna për të riorganizuar dhe vitalizuar strukturat e Sindikatës në të gjithë vendin. Pas një pune të gjatë paraprake duke studiuar strukturën aktuale u krijua struktura e re me 12 Seksione në të gjithë Shqipërinë. Në drejtorinë e përgjithshme u krijuan 6 Seksione të reja me qëllim që të gjithë punonjësit të ishin të përfaqësuar në Sindikatë. Gjithashtu u vendos që dy nga këto Seksione përvec Drejtorisë së Përgjithshme do të mbulonin edhe dy rajonet kryesore Tiranë - Durrës.

Një Seksion i vecantë u krijua për Kompaninë Makhes, që do të mbulonte kryesisht Tiranën edhe do të bashkërendonte punën me Seksionet e tjera në të gjithë Shqipërinë, ku u krijuan ndarjet e reja me 5 Seksione Rajonale. Ky organizim, me përfaqësuesit e rinj të këtyre Seksioneve dha menjëherë rezultat si në Drejtorinë e Përgjithshme Albtelecom, në Makhes e në të gjitha Rajonet

SEKSIONI	DREJTORIA / RAJONI	PËRFAQESUESI I SEKSIONIT
1	GRUPI TEKNOLOGJISË & RAJONI TIRANE –DURRES	1.SAJMIR SULAJ 2.SPARTAK MEHMETI
2	CONSUMER BUSINESS SALES & SUPPORT, CONSUMER BUSINESS MARKETING , RAJONI TIRANË - DURRËS	1.ANISA KOPRENCA 2.ARJAN BAJOLLARI
3	CUSTOMER SERVICES, ENTERPRISE BUSINESS MARKETING & IPTV, ENTERPRISE BUSINESS SALES, MARKETING COMMUNICATIONS, PUBLIC RELATIONS	1.IRIDA MARKU 2.FLORIDA MEHMETI
4	PROCUREMENT, ADMINISTRATIVE AFFAIRS, HR, LEGAL & REGULATION, CEO TEAM.	1.ARMANDO JAUPI 2.ALKET RADOVANI
5	ACCOUNTING & TAX, FINANCE OPERATIONS, BUDGETING AND REPORTING, INTERNAL AUDIT TEAM, OPERATIONAL RISK MANAGEMENT.	1.DENIS SINEBALLA 2.ARNOLD THELLIMI
6	IT GROUP	1.ARMAND BARDHI 2.GILBERT ULIU
7	FIER-BERAT-VLORË-GJIROKASTËR-SARANDË	1.THANAS DINAKU 2.MIGUELA GJINI
8	SHKODËR-LEZHË-PUKË	1.GENTIAN LACEJA 2. NIKOLL MARKU
9	POGRADEC-KORCE-PERMET	1.HATIXHE HODAJ 2.ADNAN SHAHINI
10	ELBASAN-LIBRAZHD	1.ELTON DISHO 2.ARJAN PAJOVA
11	PESHKOPI-KUKËS-TROPOJË	1.MAJLINDA PARLLAKU
12	DREJTORIA MAKHES – TIRANË + RAJONET	1.ZENEL MUCA 2. SUEL XHEMALCE



*Nga Andiola Dhëmbi,*

*Punonjësit janë aseti më i cmuar i një korporate dhe kjo njihet mjaft mirë nga punëdhënësi i Albtelecom.*

*Albtelecom është e vetmja kompani telekomunikacioni në tregun shqiptar në të cilën të drejtat e punonjësit mbrohen nga e drejta sindikale sipas rregullave që parashikon legjislacioni.*

*Ne dimë se kur punonjësit vijnë së bashku në një zë, atëherë nxitet stabilitet ekonomik, lehtësohen trazirat sociale dhe krijohen kushtet për paqen, prosperitetin, mbrojtjen e të drejtave të shoqërisë dhe të brezave.*

*Në sindikatën Postë-Telekom aderojnë një përqindje e lartë punonjësish por angazhimi dhe përfshirja e një numri më të madh e forcon më shumë sindikatën. Të gjithë e dimë se sindikata të forta bëjnë edhe demokraci të fortë duke u bërë katalizatori kryesor për të fituar demokracinë në vendin e punës por dhe më gjërë në shoqëri.*

*Detyra dhe përgjegjësia jonë është kolektive dhe sociale pasi në vendet post komuniste forcimi i sindikatave merr një vlerë të shtuar. Vendet si i joni janë ato vende ku pushteti ekonomik e politik behët i pandashëm duke rënduar hendekun e pasurisë dhe duke minuar potencialin njerëzor.*

*Misioni ynë primar është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të punonjësve përmes bashkëpunimit dypalësh. Fokusi i veprimtarisë sonë gjatë 2016-ës do të jëtë në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë në vendin e punës duke u solidarizuar të gjithë bashkë për një përfaqësim sa më të mirë kundër centralizimit dhe diskriminimit shoqëror.*

*Të gjithë së bashku mbrojmë parimin e demokracisë dhe pavaresisë së sindikatës.*

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sindikata e Punonjësve Post-Telekom, që në themelimin e saj i ka dhënë rëndësinë e duhur forcimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve me Sindikatat e tjera, vecanërisht me Sindikatat e Sektorit të komunikimeve, në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar. Në vitin 1994 SPPT bëhet anëtare e Post Telegraf International. (më vonë në vitin 2000 bashkohet me organizata të tjera për të formuar UNI Global). Sindikatat Italiane dhe Greke kanë qënë Sindikatat e para që i kanë ardhur në ndihmë SPPT-së me eksperiencën e tyre për të organizuar dhe modernizuar Sindikatën tonë. Partneriteti me sindikatat u shtri më tej me marrëveshje bashkëpunimi edhe me Sindikatat e Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë, Serbisë, Austrisë dhe se fundi edhe Sindikatat e Britanisë dhe ato Amerikane.

SPPT si anëtare e UNI Global, për dy vjet në bashkëpunim me UNI-n ka arritur të organizojë aktivitete të ndryshme edukuese duke organizuar seminare të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të Sindikatës. Bashkëpunimi nuk ka munguar as me Qendrën e Solidaritetit të Sindikatës Amerikane të cilët na kanë asistuar në seminare dhe trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2015.

Në dy vitet e fundit SPPT ka arritur të firmosë edhe dy memorandume bashkëpunimi me Sindikatën Turke Haber-IS edhe me Sindikatën e Kosovës FSP-PTK. Në të dy ceremonitë e firmosjes, SPPT është përfaqësuar nga anëtarët e Kryesisë edhe Forumeve të saj. Në të dy Memorandumet është rënë dakord të forcohet bashkëpunimi reciprok në fushën e aktivitetit Sindikal, në fushën e edukimit, organizimit të seminareve dhe aktiviteteve të tjera me karakter edukues për anëtarët e të dy sindikatave. Gjithashtu është rënë dakord organizimi i takimeve, vizitave, tryezave të punës me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe anëtarëve të të dyja Palëve. Në rast momentesh dhe rrethanash të vështira Sindikatat zotohen gjithashtu të mbështesin njëra tjetrën në mënyrë reciproke.



Ne Foto nga e majta : z. Milazim Alshiqi ( FSP-PTK, Kosove); z. Veli Solak (Haber-IS, Turqi); z. Renato Muçaj (SPPT)

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Gjatë firmosjes së Memorandumit të bashkëpunimit me Sindikatën Turke të Telekomunikacionit Haber-İS, 20 Shtator 2014. Kjo iniciativë për firmosjen e këtij memorandumi tre palësh midis Haber-İS, (Turqi) – SPPT (Shqipëri) –FSP-PTK (Turqi) u ndërmor nga kryetari i Sindikatës Turke, z. Veli Solak. Gjatë këtij takimi z.Solak deklaroi se do të mbështeste sindikatat tona dhe kërkoi që të treja palët, të rrisnin bashkëpunimin në të gjitha fushat me interes të përbashkët për zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm të sindikatave tona. Z. Mucaj, theksoj se bashkëpunime të tilla rajonale dhe shkëmbimi i eksperiencave të drejtperdrejta janë një ndihmesë e madhe për forcimin e Sindikatave tona. Takimi i të tre delegacioneve u mbyll me firmosjen e Memorandumit të Bashkëpunimit.



# SPPT – FSP-PTK MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Pas ndryshimeve të ndodhura në Sindikatën e PTK në Kosovë dhe në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit reciprok është mbajtur më datë 17 Janar 2015, një takim ndërmjet dy delegacioneve të SPPT dhe FSP-PTK, ku është firmosur edhe memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet të dy sindikatave. Kryetari SPPT-s z. Renato Muçaj & kryetari i ri i FSP-PTK z. Lamih Balaj, në fjalën e tyre kanë vlerësuar bashkëpunimin e deri tanishëm dhe janë zotuar të rrisin më tej bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave në fusha të ndryshme që kanë interes të përbashkët për të dy sindikatat. Në fund të takimit të dy Sindikatat firmosën Memorandumin e Bashkëpunimit.





# SUKSESE TË SINDIKATËS GJATË PERIUDHËS 2013 – 2015.

Përpjekjet e Sindikatës janë të përditshme por edhe të planifikuara sipas propozimeve dhe vendimeve të Këshillit Kombëtar. Ne bazë të këtyre vendimeve, drejtuesit e Sindikatës bëjnë përpjekjet maksimale për të mbrojtur të drejtat e punonjësve dhe për të plotësuar kërkesat kolektive që këta punonjës kanë në lidhje me kushtet e punës, pagesat apo trajtime të tjera që këta punonjës duhet të kenë për ta bërë punën e tyre sa më të denjë.

## 2013,

- Këtë vit kemi mundur të realizojmë një nga kërkesat tona më të rëndësishme, të cilën kishim vite që luftonim me insistim dhe jemi të lumtur që sot kjo është bërë realitet. Të gjithë punonjësve, të Albtelecom, ju është mundësuar falas nga kompania kryerja e Analizave Mjekësore një herë në vit. Gjithashtu shoqërimi i këtyre analizave me sigurimin e jetës për të gjithë punonjësit i ka tejkalluar pritshmëritë tona duke e finalizuar këtë proces me një sukses të padiskutueshëm.

- Me anë të kontratës kolektive që Sindikata ka firmosur me kompaninë, kemi arritur të hedhim firmën mbi një marrëveshje tepër favorizuese për të gjithë punonjësit. Nga kjo marrëveshje është bërë e mundur që punonjësit të përfitojnë indeksimin e pagave për vitin 2013. Gjithashtu një nga arritjet e tjera në këtë kontratë ishte shpërblimin i fundvitit, ku të gjithë punonjësit do të shpërbleheshin me rastin e festave të fundvitit me një shumë prej 30,000 lekësh.

## 2014

- Nënshkrimi i Kontratës Kolektive me Makhes - Pas takimit trepalësh midis ALBtelecom, Makhes dhe SPPT, nisën negociatat për nënshkrimin e kontrates kolektive. Pas negociatave të gjata u arrit të nënshkruhet në Shtator, 2014 Kontrata Kolektive 2 vjecare me Makhes, duke ruajtur kështu të drejtat e punonjësve të transferuar dhe përfaqësimin e tyre nga SPPT.

- 1 tetor 2014 është realizuar indeksimi i pagave për punonjësit e Albtelecom me vlerën e indeksit të shportës 1.9 % me efekt që nga nga muaj mars 2014.

- Me anë të përpjekjeve të Sindikatës, u arrit që punonjësit e Makhes të përfitonin për vitin e ri një shpërblim prej 5,000 lekë.

## 2015

- Firmosja e Kontrates Kolektive me Albtelecom – Në muajin shkurt pas negociatave disa ditore u arrit të finalizohet kontrata 2 vjecare kolektive me Albtelecom 2015-2017.

- Fushata Fix-IT - Në 10.12.2015, u ndërmor fushata "FIX IT", që ishte një hap më i fortë për të përcjellë mesazhin e punonjësve për ndryshimin e Orarit të Menaxhimi i Lartë. Kjo fushatë u frymëzua nga të gjithë eksperiencat dhe inskenimet e aplikuara gjatë seminarit për organizimin. Rezultij një fushatë shumë e sukseshme pasi u arrit qëllimi për ndryshimin e orarit.

- Me anë të përpjekjeve të Sindikatës, u arrit që punonjësit e Makhes të përfitonin edhe këtë vit një shpërblim prej 5,000 lekë për Vitin e Ri.

# NJË SINDIKATË MË INTELIGJENTE ....

Një rëndësi të vecantë në luftën sindikale zë pjesa e edukimit si për përfaqësuesit e Sindikatës ashtu edhe për anëtarët e saj. Ka qënë pikërisht vullneti i Kryetarit z. Mucaj për të rritur sa më shumë numrin e Seminarëve edukues për të gjithë përfaqësuesit e Sindikatës. Ideja për të pasur një sindikatë të fuqishme jo vetëm në lëvizje por edhe një sindikatë inteligjente me kapacitete të larta të të menduarit dhe të vepruarit ka qënë një nga objektivat kryesore që kur Kryetari i ri i SPPT-së ka marrë detyrën e tij në vitin 2014.

Duke përdorur të gjitha lidhjet me partnerët tanë kemi arritur të rrisim ndjeshëm seminarët edukues mbi format e reja të organizimit të Sindikatës. Bashkëpunimi i shkëlqyer me UNI Global Union dhe me Solidarity Center (AFL-CIO – Sindikata Amerikane), por dhe besimi që këto dy institucione prestigjioze kanë krijuar gjatë punës me Sindikatën tonë, ka sjellë një numër të lartë Seminaresh për mënyrat e reja perëndimore të menaxhimit dhe organizimit të Sindikatës. Gjithashtu nga ana tjetër Z. Mucaj ka vënë në dispozicion të gjithë fuqinë e burimeve njerëzore të sindikatës, të cilët janë përkushtuar maksimalisht për të përthithur këto mënyra të reja dhe për ti vënë ato në zbatim me rigorozitetin e duhur. Pjesëmarrja e lartë gjatë këtyre Seminareve dhe përkushtimi i përfaqësuesve të Sindikatës, ka rritur në maksimum efikasitetin e lëvizjes së SPPT-së edhe me fushata konkrete sic ishte Fushata Fix-IT ku të gjithë punonjësit nën drejtimin e përfaqësuesve të Sindikatës arritën të përçonin mesazhin e tyre te drejtuesit e Kompanisë.

Ky bashkëpunim ka shërbyer për të rritur besimin e këtyre institucioneve për një lëvizje të vërtetë Sindikale në Shqipëri, dhe për ti dhënë SPPT-së shansin që të jetë një shembull i kësaj lëvizjes Sindikaliste. SPPT nga ana tjetër është angazhuar që të rrisë kapacitetet e saj dhe të shtyjë përpara këtë lëvizje me shtrirjen e përfaqësimit të saj edhe në kompani të tjera të fushës së informacionit dhe komunikimit.

Në të njëjtën mënyrë, SPPT edhe në rrafshin kombëtar ka rritur bashkëpunimin si me BSPSH-në ashtu edhe me institucionet shtetërore si dhe me institucione të tjera prestigjioze si Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) dhe Eömen Democracy Network (WDN). Këto bashkëpunime kanë qënë si për çështjet e SPPT-së ashtu edhe për çështje kombëtare, sic kanë qënë ndryshimet e kodit të punës në vitin 2015. Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe WDN, e cila ka trajnuar përfaqësuesit tanë mbi leadershipin dhe etikën gjatë fushatës së anketimit por në të njëjtën kohë ka vënë në dispozicionin tonë edhe ambientet e tyre për takimet periodike që mbaheshin çdo javë për kordinimin e kesaj fushate nën mbikëqyrjen edhe të përfaqësuesit të AFL-CIO-se z. Fielding. Gjatë studimit për DT, një bashkëpunim të vecantë SPPT ka pasur edhe me znj. Frosina Gjino të Qendrës Shqiptare për Sigurinë e Shëndetin në Punë.

# SEMINAR UNI – SPPT, GUSHT 2014

Në muajin Gusht 2014 u mbajt edhe Seminari i parë mbi planifikim strategjik të Sindikatës për të hartuar rrugën e saj të re nën drejtimin e Kryetarit të sapo zgjedhur. UNI Global u tregua e gatshme të jepte ndihmën e parë duke mbajtur këtë Seminar me përfaqësuesin e saj për Rajonin e Europës Juglindore z. Javier Carles. Kjo do të ishte një nisje e shkëlqyer për të ardhmen e Sindikatës sonë. Z. Carles u shpreh i bindur që në të ardhmen do të shtohet bashkëpunimi UNI-SPPT për të ngritur kapacitetet intelektuale të Sindikatës.



Gjate zhvillimit te Seminarit me përfaqësuesin e UNI-t.

## SEMINAR EDUKUES NE ALBTELECOM

SPPT në kuadrin e edukimit ka propozuar mbajtjen e Seminarit me komisioneren e parë të mbrojtjes së të dhënave personale znj. Flora Cabej. Një seminar i shkëlqyer i propozuar nga Sindikata dhe organizuar nga ALBtelecom, për të informuar punonjësit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.



## PREZANTIMI I STUDIMIT TE DEUTSCHE TELEKOM SPPT – UNI – AFL-CIO – FES - AOSHC

Një takim produktiv me UNI, Qëndren e Solidaritetit, FES, Kërkuesen znj. Frosina Gjino dhe anëtarët e Kryesisë dhe të forumeve të SPPT-së. Gjatë këtij takimi znj. Frosina Gjino nga AOSHC prezantoi Studimin për Deutsche Telekom në Shqipëri i cili vinte theksin te kushtet e përgjithshme, atmosfera, kushtet e punës dhe problematikat që kishin punonjësit në DT. (AMC) Gjithashtu gjatë takimit z. Frank Hantke referoi për Qendrën e Solidaritetit dhe UNI situatën e lëvizjes Sindikale në Shqipëri. Në pjesën e dytë u diskutua me gjërësisht për sfidat e SPPT-së në të ardhmen dhe Eksperienca e Qendrës së Solidaritetit në Organizim.





## SEMINAR SPPT – UNI – AFL-CIO

Në datat 1-3 Tetor 2015, në Tiranë SPPT ka zhvilluar seminarin 3 ditor mbi rritjen e aftësive për organizimin e Sindikatës. Me ndihmën e partnerëve tanë, Sindikatës Amerikane AFL-CIO, Solidarity Center dhe UniGlobal është bërë i mundur zhvillimi i këtij seminary, i cili ka qënë një sukses i padiskutueshëm për Sindikatën tonë. Në Seminar Qendra e Solidaritetit dhe UNI Global kanë sjellë eksperiencën perëndimore në organizim dhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme me të cilat mund të përballet Sindikata. Gjatë seminarit janë inskenuar situata te ndryshme të cilat kanë shërbyer për të kuptuar më mirë zgjidhjen praktike të këtyre problemeve në bazë të vështirsisë së tyre. Seminari 3 ditor ka ndihmuar shumë pjesëmarrësit dhe ka arritur ndjeshëm njohuritë e tyre mbi organizimin.



## SEMINAR SPPT - WDN

25.10.2015, SPPT në bashkëpunim me Institutin WDN, realizoi trajnimin mbi rritjen e kapacitetit dhe forcimit të lidershit të përfaqësuesve të Sindikatës. Kodi I etikës dhe parimet që duhet të mbahen parasysh gjatë trajtimit të problematikave. Teknikat dhe mënyra e zhvillimit të një Anketimi. Ky trajnim u mbajt nga Presidentja e WDN, znj Blerta Balilaj.



## SEMINAR SPPT- SOLIDARITY CENTER

Ne dt. 12-13 Dhjetor 2015 është mbajtur Seminari midis SPPT - AFLCIO ( Qëndrës së Solidaritetit të Konfederatës Amerikane). Gjatë këtij Seminari dy ditor, përfaqësuesit e Sindikatës Amerikane u përqëndruan në vazhdimësinë e Seminareve të mëparshme për të rritur aftësitë e përfaqësuesve tanë mbi organizimin dhe përgatitjen e fushatave të ndryshme për aktivitetin Sindikal. Gjatë seminarit lektorët Amerikanë inskenuan skenarë te ndryshëm duke u përqëndruar në punën në grup të të gjithë pjesëmarrësve për hartimin e fushatave të ndryshme.



# TAKIMI I DEUTSCHE TELEKOM ALLIANCE

Më 30-31 tetor 2014 u zhvillua në Bukuresht takimin vjetor i Aleancës së Sindikatave të Deutsche Telekom CEE, organizuar nga UNI Global Union, Friedrich Ebert Stiftung, Qendra Solidaritetit AFL-CIO dhe FSCOM.

Një numër Sindikatash nga Shqipëria, Bosnje dhe Herzegovina, Kroacia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Shtetet e Bashkuara morën pjesë në këtë takim së bashku me UNI Global Union.



Ky takim synonte paraqitjen e raporteve kombëtare për pajtueshmëri me të drejtat e punëtorëve nga operacionet DT në vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore dhe planifikimin e veprimeve të bashkëpunimit globale midis sindikatave të filialeve Deutsche Telekom në periudhën e ardhshme.

Pjesëmarrësit vunë në dukje problemet e shumta me të cilat përballen punëtorët e Telekom përfshirë dhënien, përdorimin e studentëve dhe punëtorve me kohë të pjesshme, masave shtrënguese dhe zvogëlimin e të ardhurave, si dhe shkeljet e të drejtave të punëtorëve dhe të standardeve ndërkombëtare të punës. Sindikata jonë shprehu gjithashtu shqetësimin e pengesës së punonjësve për tu organizuar në sindikatë si pasojë e penalizimeve të mëparshme nga kompania.

Pjesëmarrësit ranë dakord që prioritet është arritja e standardeve të njëjta për punëtorët "gjatë procesit të riorganizimit dhe ndërtimit të një DT të vetme, brenda dhe jashtë Gjermanisë. Ne shpresojmë se komunikimi konstruktiv me Drejtorin e Përgjithshëm të DT në nivel lokal, rajonal dhe global do të japë një farë përparimi.

Proceset e ristrukturimit dhe të outsourcing (nënkontraktimi) duhet të jenë elementë qëndrorë në dialogun e përmendur. Çështje më e rëndësishme për sindikatat tona janë kufizimet në lirinë e asocimit dhe forcimin e bisedimeve kolektive.

Nëse Drejtori i Përgjithshëm i DT nuk do të adresojë këto probleme seriozisht sindikatat e Aleancës janë të angazhuar për organizimin e protestave dhe veprimeve të përbashkëta. Zëri ynë do të dëgjohet nëpërmjet letrave, peticioneve dhe demonstratave.

Gjithashtu i bëhet thirrje Komisionit Evropian për të siguruar që interesat e punëtorëve të njihen, dhe të mbrohen vendet dhe kushtet e punës sipas ndryshimeve që po ndodhin në rregulloret e telekomeve evropiane.

**Solidariteti është çelësi! Unitetit është forca!**

SPPT & Aleanca e Sindikatave Deutsche Telekom  
UNI Global Union

# MBLIDHET KESHILLI KOMBETAR!

Këshilli Kombëtar, i SPPT-së është organi me i larte gjate periudhes midis kongreseve, dhe miratohet nga kongresi i radhes. Këshilli Kombetar është shprehje e ekuilibrit midis strukturave sindikale dhe mbledhet minimalisht 1 here ne 6 muaj. Këshilli përcakton strategjinë, merr vendime për aktivitetin sindikal, aprovon pasqyrat financiare dhe buxhetin e Sindikatës. Gjatë vitit 2015 Këshilli Kombëtar ka mbajtur dy mbledhjet e tij në datë 19.06.2015, dhe në datë 19.12.2015, ku ka analizuar aktivitetin e sindikates, dhe objektivat për gjashte mujorët përkatës.

Gjatë këtyre mbledhjeve nuk kanë munguar diskutimet dhe ngritja e problematikave me te cilet anëtarët e keshillit përballen në vendet e punës duke sjell në këto mbledhje zërin e punonjësve që ata përfaqësojnë. Alternimi i gjinive, moshave, profesioneve dhe forimimit të antarëve sjellin në këte keshill diskutime teper cilësore dhe kendveshtrime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve. Vendimet në keshill merren kur për të voton më shumë se gjysma e keshillit. Votimi bëhet i hapur në sy të të gjithëve antarëve te keshillit.

Gjatë mbledhjes së Dhjetorit 2015, keshilli ka votuar për ndryshimet në organizimin e keshillit dhe strukturat e sindikates, për planin e aktiviteteve, pasqyrat financiare, dhe projekt buxhetin e vitit 2016. Gjithashtu në mbledhjen e Dhjetorit u votua edhe projekt ideaje e logos së re dhe vazhdimi i politikave të forcimit dhe zgjerimit të sindikatës.





## TAKIME ME SEKSIONET

Gjatë muajit Nëntor 2015 Sindikata ka ndërmarrë një fushatë anketimi për punonjësit e Albtelecom. Qëllimi i anketimit ka qënë, informimi i tyre mbi aktivitetin e sindikatës, evindetimi i problemeve të punonjësve dhe vlerësimi i tyre për punën e Sindikatës deri tani. Ky anketim që u shtri në të gjithë Shqipërinë u përdor njëkohësisht për të takuar pjesën më të madhe të anëtarëve në Seksionet tona. Kryetari i Sindikatës është takuar me të gjithë përfaqësuesit e Seksioneve dhe bashkarisht kanë vizituar punonjësit në ambjentet e tyre të punës. Pas evidentimit të problemeve me të gjithë seksionet janë mbajtur takime për të analizuar problematikat e çdo seksioni. Gjatë këtyre takimeve Kryetari z. Muçaj ka shprehur mbështetjen për përfaqësuesit e Seksioneve dhe ka vlerësuar punën e mirë që ata kanë bërë deri tani në seksionet e tyre.



Sarandë, Me përfaqësuesen e Seksionit 7



Vlorë me punonjëset e Seksionit 7



Lezhë, me z. Nikoll Marku, përfaqësuesi i Seksionit 8




Shkodër, me Përfaqësuesit e Seksionit 8, z.Nikoll Marku & z. Gentian Laceyja

# TAKIME ME SEKSIONET



Korçë me Punonjësit e Seksionit 9



Përmet. me përfaqësuesen e Seksionit 9,  
znj. Hatixhe Hodaj



Takim me punonjësit e Delvinës, Seksioni 7



Korçë me përfaqësuesin e Seksionit 9,  
z. Adnan Shahini



Lushnje, Albtelecom Shop, Seksioni 7

# TAKIM ME SEKSIONIN 12 – MAKHES

Në vazhdim të takimeve, me seksionet e SPPT-së për të dëgjuar problematikat e anëtarëve, është mbajtur në dt. 16 Shtator 2015, në ambientet e Muzeut Kombëtar, takimi me Seksionin 12, Makhes. Gjatë këtij takimi është bërë prezantimi i aktivitetit të sindikatës dhe gjithashtu është diskutuar gjatë nga të gjithë pjesëmarrësit për problematikat që ka ky seksion. Drejtuesit e SPPT-së kanë shprehur vendosmerinë për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të këtij seksioni duke mos lejuar asnjë shkëlqje që mund të jetë në kundërshtim me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive. Në përfundim të analizës së kryer gjatë këtij takimi është vendosur për masat që do të merren për të gjitha problematikat dhe kërkesat e këtij seksioni. Më pas për të gjithë pjesëmarrësit është shtruar një koktejl.



## TAKIM ME DREJTUESIT E MAKHES!

Të gjithë problemetikat e dala nga takimi me punonjësit e Makhes në Tiranë i janë paraqitur drejtuesve të Makhes gjatë takimeve periodikeve të organizuara me ta. Gjithashtu drejt Makhes & Altelecom është drejtuar një letër zyrtare me te gjitha kerkesat kryesore të teknikëve. Ne këtë kërkesë konkretisht është kërkuar dhe vazhdojnë përpjeket per realizimin e këtyre tre kërkesave.

- Ndalimi i Punës së detyruar ne Festa Zyrtare dhe Respektimi i Pushimit Javor.
- Informacion i mbi Pagën dhe Orët jashtë orarit.
- Indeksimi i Pagës.



Të gjithë Teknikët janë informuar në takime zyrtare nga Përfaqesuesit e Sindikatës në lidhje me kerkesat e tyre e paraqitur nga Sindikata e Punonjësve Postë-Telekom dhe ndjekjen me rigorozitet te ketyre kërkesave deri në realizimin e tyre.



# FUSHATA FIX IT!

**FIX IT !  
16:30K**

Pikërisht në datën 10/12/2015, në ditën Botërore të të Drejtave të Njeriut me qindra punonjës të Albtelecom i janë bashkuar fushatës sensibilizuese, për ndryshimin e orarit të punës pas firmosjes së një peticioni për largimin nga vendi i punës në orën 16:30 duke evituar kështu orët e rënduara në trafik. Mos marrja parasysh nga kompania e kërkesës së punonjësve dhe shqetësimi në rritje i punonjësve, bëri që sindikata të ndërhynte me veprime konkrete. Të gjithë punonjësit nën organizimin e Sindikatës vendosën të mbanin në bluzat e tyre për një ditë etiketa sensibilizuese me sloganin FIX-IT 16:30K dhe një zëri kerkuan edhe njëherë ndryshim dhe largim më herët nga puna. Ky veprim kolektiv bëri që punëdhënësi, të reflektonte dhe të bisedonte me Sindikatën për ndryshimin e orarit sipas kërkesës së punonjësve. Të gjithë punonjësit arritën të kuptojnë se vetëm të gjithë sëbashku bëhen më të fuqishëm dhe luftojmë për të plotësuar kërkesat dhe të drejtat tona!



## SPPT PJESË E FUSHATAVE SENSIBILIZUESE!

“CONTACT CENTER” JAVA PER VEPRIM, 19 – 25 Tetor 2015 !  
PËR TË SENSIBILIZUAR TË GJITHË PUNONJËSIT E “CONTACT CENTER”

Kjo fushatë një javore u organizua që të gjithë punonjësit e Contact Center të ndërgjegjësohen se të drejtat e tyre nuk respektohen sa duhet. Sot është dita kur ata duhet të kuptojnë se sa shumë nevojitet një Sindikate, të kuptojnë se ju duhet një zë, i cili t’i bashkojë për ta bërë punën në Contact Center një punë dinjitoze, një profesion, një punë më të paguar, një profesion më të respektuar. Sot, bashkimi global i Sindikatave UNI Global Union, ku dhe ne bëjmë pjesë si Sindikate e punonjësve të telekomunikacionit, ka filluar javën për veprim (UNI ICTS Contact Centres). Si partnere dhe në mbështetje të kësaj fushate ne kemi ndarë në të gjitha rrjetet tona sociale video sensibilizuese të përgatitur nga UNI Global. Sindikata e Punonjësve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT është treguar e gatshme të mirëpresë edhe të ofrojë asistencën e saj NE ÇDO KOHË për punonjësit e Contact Center. Eshte koha per veprim.



### FUSHATË DHURIMI PER **Z. DRITAN SKENDERAJ**

Pas informacionit për aksidentin që kishte pësuar kolegu yne z. Dritan Skënderaj, Sindikata ka filluar organizimin e një fushate për mbledhjen e fondeve në Albtelecom. Punonjësit mund të dhuronin direkt në llogarinë e z. Dritan ose pranë përfaqësuesve të Sindikatës. Gjithashtu edhe punonjësit e Makhes janë organizuar për mbledhjen e fondeve në Makhes. Në fund të kësaj fushate janë arritur të mbledhen rreth 370,000 lekë të reja të cilat i janë dhuruar z. Dritan, nga Kryetari z. Renato Mucaj dhe Sekretarja e Përgjithshme znj. Andiola Dhembli.

SPPT në vazhdim të fushatës së Albtelecom, ka ftuar të gjithë përfaqësuesit e saj të tregojnë solidaritetin e tyre më të lartë duke dhuruar gjak. Drejtuesit e Sindikatës kanë qënë në krye të kësaj fushate për të qënë të parët për të dhuruar gjak. Të gjithë sëbashku për të shpëtuar jetë.

You don't have to be a doctor to save lives.



**Just donate blood.**

Do you know that just a pint of blood can save up to 3 lives?  
Donating blood is safe. It's painless, simple, and noble.

## TAKIME TE NDRYSHME NGA AKTIVITETETI SINDIKAL I SPPT-së. 2014-2015

Në Korrik 2015, është mbajtur takimi me Sindikatat e BSPSH-së dhe Ministrisë së Mirëqënies dhe Çështjeve Sociale, ku është kërkuar mbështetja e Sindikatave gjatë fushatës së Informalitetit. Më pas po në këtë ditë është mbajtur edhe Mbledhja e Këshillit Kombëtar të BSPSH-së në të dy këto takime Sindikata është përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithëshme, znj. Andiola Dhemi.



Në 18-19 Tetor 2014, Në kuadër të partneritetit Strategjik, Këshilli Kombëtar i ri, me ftesë të Sindikatës së Kosovës ka vizituar vëllezërit dhe motrat tona të Sindikatës së Kosovës, në Prizren dhe Prishtinë.

## TAKIME PER KODIN E PUNËS - SINDIKATAT & FES

Më datë 15.Tetor.2015, Fes-Albania, ka organizuar në ambjentet e Hotel Sokrat, një takim me sindikatat për ndryshimet në Kodin e Punës, duke analizuar problematikat që mund të sjellin këto ndryshime në të drejtat e punonjësve. Ky takim u drejtua nga lektori dhe eksperti ligjor z. Ledio Milkani. Në këtë takim Sindikata jonë është përfaqësuar nga Kryetari z. Renato Muçaj.



## TAKIM BSPSH – AFL-CIO- SPPT

Me kërkesën e Sindikatës Amerikane AFL-CIO, është mbajtur takimi me BSPSH-në dhe përfaqësuesin e AFL-CIO, z. Bob Fielding. Në këtë takim ka qënë i ftuar edhe Kryetari i SPPT-së z. Renato Muçaj. Gjatë takimit z. Fielding pasi është njohur më shumë me jetën sindikale të BSPSH dhe punën e saj në këto vite, ka shprehur qartasi mbështetjen që ata po i japin SPPT-se dhe ka kërkuar më shumë mbështetje edhe nga BSPSH ndaj SPPT-së, si partner i tyre në projekte të ndryshme për forcimin e aktivitetit. Z. Kalaja e ka siguruar që SPPT si themeluese e BSPSH-së do të marrë mbështetjen e duhur në këtë drejtim. Takimi midis AFL-CIO – BSPSH dhe SPPT u mbyll me një vizitë në zyrat e BSPSH-se dhe një pasqyrimi të historisë së sindikalizmit me anë të fotove ndër vite.



## TAKIM ME ZNJ. FROSINA GJINO,

## PER STUDIMIN E DEUTSCHE TELEKOM.

Si pjesë e Aleancës të DT-së , Sindikata jonë ka dhënë kontributin e saj duke bashkëpunuar në mënyrë të ndërsjelltë me znj. Frosina Gjino, të Qendrës Shqiptare për Sigurinë e Shëndetin në Punë, e cila ishte ngarkuar me studimin e kushteve të punonjësve në AMC. Përfaqësuesit e Sindikatës kanë pjesë në takime edhe në intervista të cilat zhvilloheshin për qëllimin e studimit.



## TAKIME PER KODIN E PUNËS - BSPSH & FES



Në dt 12.02.2016 në zyrat e BSPSH, në bashkëpunim me FES u zhvillua seminari me temë " Ndryshimet në Kodin e Punës" , ku morën pjesë të gjitha federatat. Lektorit Ledio Milkani zhvilloi debate të ndryshme në lidhje me ndryshimet e fundit në K. Punës si dhe me Konventat e ILO-s. Prezantime të tjera u mbajtën nga Renato Mucaj, Elgan Lami , Hiqmet Melasi , Myftar Ismalaja , Bruno Hoxha etj.

## TAKIM BSPSH – AFL-CIO- SPPT

Përfaqësuesi i ri i AFL-CIO z. Laurie Clements zhvilloi një takim me Presidentin e BSPSH z. Gezim Kalaja në selinë e BSPSH . Në këtë takim ishte zv. Presidenti i SPMSH z. Jonuz Xhetani dhe Presidenti i Sindikatës së Punonjësve të Poste- Telekomit Shqiptar z. Renato Mucaj. Z. Clements zhvilloi trajnimin 2 ditor me sindikalistë të SPPT dhe kërkoi bashkëpunim për seminare në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.






# SINDIKATA NË FUNKSION TË ANËTARËVE ME RISI TË REJA....

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Sindikatës, datë 13 Dhjetor 2014, me propozim të Kryesisë u vendos që me rastin e festes së Vitit të Ri, Sindikata, të ishte më pranë anëtarëve të saj duke dërguar të çdo ANËTAR një dhuratë simbolike në shenjë mirënjohje si pjesë e Sindikatës dhe gjithashtu për t'ju uruar festën e fundvitit.

Ky vlerësimin vjen si vazhdim i vizionit të ri të Sindikatës për të pasur politika diferencuese për të gjithë anëtarët duke i dhënë atyre vlerësimin e merituar për kontributin dhe mbështetjen që ata i japin Sindikatës.

Gjithashtu kjo mënyrë ka shërbyer për të sensibilizuar çdo punonjës, për tu bërë pjesë e Sindikatës sonë, sepse nëse duam të kemi një Sindikatë sa më të fortë, skepticizmi duhet të lërë vendin, përfshirjes, kontributit dhe bashkimit në Sindikatë të të gjithë punonjësve. Përveç bashkimit dhe rritjes së kontributit nuk ka rrugë tjetër sepse Sindikalizmi nuk është një betejë që fitohet njëherë por mbetet një luftë e vazhdueshme në mbrojtje të interesave të anëtarëve të saj.

Kjo ka qënë thirrja dhe urimi që kryetari z. Renato Mucaj i ka dërguar të gjithë punonjësve në prag të vitit të ri 2015 !



# TI MUND TE JESH ANËTARI ME FAT!.... SHORTEU I VERES PËR PUSHIME VERORE!

Në vijim të politikave të reja të SPPT-së duke vënë Sindikatën në funksion të anëtarëve tanë, ditën e Premte dt. 24.07.2015 është hedhur shorteu për 4 fletë kampi që janë ndarë për të dy kompanitë, 2 flete kampi për Makhes dhe 2 për Altelecom. Këto fletë kampi të siguruar nga BSPSH kanë bërë të mundur që të dergohen katër anëtar me fat për pushime verore në Kompleksin Florida, Durrës.

Në përfundim të shorteut janë zgjedhur 3 emra për një fletë kampi në mënyrë që çdo fletë kampi të kishte dy emra zëvendësues. Në fund të procesit që u ndoq nga dhjetra punonjës komisioni i shorteut shpalli fituesit e fletëve të kampit.



# AKTIVITETE SOCIAL KULTURORE PËR PUNONJËSIT



# AKTIVITETE SOCIAL KULTURORE PËR PUNONJËSIT

SPPT, në vazhdim të aktiviteteve, me seksionin e Teknologjise, në një aktivitet social - kulturor, në Manastirin e Ardenicës dhe Parkut Arkeologjik Apoloni. Në fillim është bërë një vizitë në Manastirin e Ardenicës dhe më pas një vizitë në Muzeun dhe Parkun Arkeologjik të Qytetit të lashtë të Apollonisë. Më pas programi ka vazhduar me një drekë festive në ambjentet e Parkut



# AKTIVITETE SOCIAL KULTURORE PËR PUNONJËSIT



## DARKA IFTARIT NGA SINDIKATA



Sic është bërë një traditë tashmë Sindikata edhe këtë vit ka shtruar për të gjithë punonjësit besimtarë Darkën e Iftarit gjatë muajit të Shenjtë të Ramazanit, ku kan

# AKTIVITETE SOCIAL KULTURORE PËR PUNONJËSIT

SPPT, në një aktivitet me Seksionin 4 në Valbonë, ku anëtarët patën mundësi të prekin nga afër bukuritë e kësaj zone kaq të bukur të Shqipërisë Veriore. Mbas akomodimit të gjithë sëbashku kanë udhëtuar për te Ujvara e Rragamit, në kembë për rreth 60 minuta. Mbas ecjes në natyrë programi ka vazhduar me një darkë festive deri në orët e para të mëngjesit. Të nesërmen përpara kthimit në Tiranë të gjithë kanë shijuar akulloret e shijshme të Barjam Currit.



# NE KETE RRUGE TE VESHTIRE NJE FALENDERIM PER TE GJITHE PARTNERET TANE!



Sindikata e Punonjësve Post-Telekom  
25 vite  
Post-Telekom

